



AKREDITIMI I KOSOVËS  
ACCREDITATION OF KOSOVO

**Drejtoria e Akreditimit e Kosovës**

Tel: 038 20036563

Ueb-faqja: [www.dak-ks.org](http://www.dak-ks.org)

**AKREDITIMI I LABORATORËVE  
TESTUES  
DHE KALIBRUES SIPAS SK EN ISO/IEC 17025**

**DAK-DD-001**

**MIRATUAR NGA,  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM  
Osman HAJDINI**

## **PËRMBAJTJA**

<b>1. QËLLIMI.....</b>	<b>3</b>
<b>2. REFERENCAT .....</b>	<b>3</b>
<b>3. FJALORI DHE SHKURTESAT .....</b>	<b>3</b>
<b>4. KRITERET PËR AKREDITIM.....</b>	<b>3</b>
<b>5. ASPEKTET LIDHUR ME PROCESIN E AKREDITIMIT TË TVK-ve .....</b>	<b>3</b>
<b>6. ASPEKTET QË NDERLIDHEN ME APLIKIMIN E STANDARDIT TË AKREDITIMIT SK EN ISO / IEC 17025.....</b>	<b>4</b>
<b>7. HISTORIA.....</b>	<b>6</b>

## **1. QËLLIMI**

Ky dokument e mbështetet laboratorët testues dhe kalibrues në interpretimin e kërkesave individuale të përcaktuara në SK ISO / IEC 17025: 2007 për të siguruar një aplikim uniform dhe konsistent. Dokumenti duhet të përdoret nga vlerësuesit e DAK gjatë procesit të akreditimit të laboratorëve të testimit dhe kalibrimit.

## **2. REFERENCAT**

SK EN ISO/IEC 17025:2007 - “Kërkesat e përgjithshme të kompetencave të laboratorëve testues dhe kalibrues”.

## **3. FJALORI DHE SHKURTESAT**

### **3.1 Fjalori**

Ky dokument përdor termat dhe përkufizimet e përmendura në dokumentet referuese të parashikuara në kapitullin 2 dhe ato të specifikuar në ISO / IEC 17000: 2005 Vlerësimi i konformitetit - Fjalori dhe parimet e përgjithshme.

### **3.2 Shkurtesat**

DAK Drejtoria e Akreditimit e Kosovës  
EA European Cooperation for Accreditation  
IAF International Accreditation Forum  
ILAC International Laboratory Accreditation Cooperation

## **4. KRITERET PËR AKREDITIM**

### **4.1 Standardi i Akreditimit**

SK EN ISO/IEC 17025:2007 - Kërkesat e përgjithshme të kompetencave të laboratorëve testues dhe kalibrues”.

### **4.2 Dokumentet e EA, ILAC**

- Laboratorët Testues: EA-4/16G:2003; EA-4/18 INF:2010; ILAC-P9:2014; ILAC-P10:2013; ILAC-P14:2013
- Laboratorët kalibrues: EA-4/02M:2013; EA-4/18 INF:2010; ILAC-P9:2014; ILAC-P10:2013; ILAC-P14:2013

### **4.3 Dokumentet e DAK**

- DAK-PO-004 - Politika për përdorim të logos dhe simbolit të DAK-së
- DAK-PO-005 – Politika për përdorimin e PT dhe ILC
- DAK-PO-006 – Politika për gjurmueshmërinë e matjes
- DAK-DK-001 – Procesi i akreditimit

## **5. ASPEKTET LIDHUR ME PROCESIN E AKREDITIMIT TË TVK-ve**

Procesi i akreditimit kryhet sipas DAK-DK-001, por duke marrë gjithashtu parasysh edhe vlerësimin me dëshmi:

Gjatë ciklit të akreditimit, çdo personel aktiv i laboratorit duhet të vëzhgohet në vend në aktivitetet e laboratorit, të paktën një herë. Në rast se kjo nuk është e mundur, DAK do të vlerësojë të dhëna të tjera në lidhje me vlerësimin e performancës ose trajnimin e mëtejshëm në mënyrë të mjaftueshme mbështesin dëshminë që personeli i laboratorit vazhdon të punoj me kompetencë.

Para dhënies së akreditimit, duhet të kryhet të paktën një vlerësim me dëshmi. Nëse laboratori testues / kalibruer mbulon disa fusha teknike të laboratorit, ka një numër të madh të personelit të laboratorit/ ose disa lokacione ose nëse disa vlerësime me dëshmi nuk mund të kryhen për arsye praktike, numri i kërkuar i vlerësimeve me dëshmi do të përcaktohet individualisht para dhënies së akreditimit dhe bazuar në kërkesat specifike të sektorit.

## **6. ASPEKTET QË NDËRLIDHEN ME APLIKIMIN E STANDARDIT TË AKREDITIMIT SK EN ISO / IEC 17025**

Ky dokument ndjek artikujt e standardit. Titujt e kapitujve janë shkruar në italikë.

Ky dokument duhet të lexohet së bashku me ILAC P10.

### ***Pika 2 Politika e ILAC për gjurmueshmërinë e mbuluar nga marrëveshja ilac në kalibrim***

Kërkesa e përgjithshme për gjurmueshmërinë në ISO / IEC 17025: 2005 është:

*5.6.1 Të gjitha pajisjet e përdorura për teste dhe /ose kalibrime, duke përfshirë pajisjet për matjet shitesë (p.sh. për kushtet e mjedisit) që kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi saktësinë ose vlefshmërinë e rezultatit të testit, kalibrimit ose marrjes së mostrave duhen të kalibrohet para se të vihet në shërbim.*

Është një detyrim i laboratorit për të justifikuar nevojën për kalibrim. Në ISO / IEC 17025: 2005, kërkesa e mëtejshme e gjurmimit për laboratorët e kalibrimit është:

*5.6.2.1.1 Për laboratorët e kalibrimit, programi për kalibrimin e pajisjeve duhet të projektohet dhe operoj në mënyrë që të sigurojnë që kalibrimet dhe matjet e bëra nga laboratori të jenë të gjurmueshme në Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI) (Système international d'unités).*

Për standardet e referencës kërkesat e gjurmueshmërisë së ISO / IEC 17025: 2005 janë:

*5.6.3.1 Laboratori duhet të ketë një program dhe procedurë për kalibrimin e Standardeve referente. Standardet referente do të kalibrohen nga një trup që mund të sigurojë gjurmueshmërinë siç përshkruhet në 5.6.2.1. Standardet e tilla referuese të matjes të siguruara nga laboratori duhet të përdoren vetëm për kalibrim dhe për asnjë qëllim tjetër, përveç nëse mund të tregohet se performanca e tyre si standarde reference nuk do të shfuqizohet. Standardet e referencës do të kalibrohen para dhe pas çdo rregullimi.*

Për të ruajtur gjurmueshmërinë në programet e kalibrimit, udhëzimet mund të gjenden në *ILAC G24:2007* <sup>[4]</sup> “Guidelines for the determination of calibration intervals of measuring instruments.

Trupi inspektues do të identifikojë rreziqet për paanshmërinë dhe do të përcaktohen masat për eliminimin ose minimizimin e këtyre rreziqeve. Një analizë e rreziqeve duhet të bëhet çdo vit ose çdo

herë që ndodh një rrezik. Kjo analizë do të përfshijë analizën e trupit të ndërlidhur. Shembuj të marrëdhënieve që mund të ndikojnë në paanshmërinë janë të detajuara në artin ILAC P10. 4.1.3b.

### ***Pika 5 Kërkesat strukturore***

Laboratori ose organizata e të cilit është pjesë duhet të jetë një entitet që mund të mbajë përgjegjësi ligjore. Nëse laboratorit është pjesë e një organizate që kryen veprimtari të ndryshme nga testimi dhe /ose kalibrimi, përgjegjësitë e personelit kryesor në organizatë që kanë një përfshirje ose ndikim në aktivitetet e testimit dhe/ose kalibrimit të laboratorit duhet të përcaktohen me qëllim që të identifikohen konfliktet potenciale të interesit.

[Kodi NACE 7120 duhet të specifikohet në dokumentet ligjore të laboratorëve.](#)

[Trupi inspektues duhet të ketë një sigurim për të mbuluar detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e saj.](#)

### ***Pika 6 Kërkesat e burimeve***

#### **Personeli**

Kompetenca e nevojshme për personelin e laboratorëve testues /kalibruer që bën analiza duhet të ketë njohuri për sa më poshtë: të përdorë pajisje specifike, të kryejë teste dhe /ose kalibrime, të vlerësojë rezultatet dhe të nënshkruajë raportet e testimit dhe certifikatat e kalibrimit. Kur përdoret stafi që është duke u trajnuar, duhet të sigurohet mbikëqyrja e duhur. Personeli që kryen detyra specifike do të kualifikohet në bazë të arsimit, aftësisë, përvojës dhe /ose aftësive të demonstruar, siç kërkohet.

Personeli i laboratorëve testues / kalibruer që bën analiza do të ketë përgjegjësitë e nevojshme që përfshijnë të paktën sa më poshtë:

- ✓ përgjegjësitë në lidhje me kryerjen e testeve dhe /ose kalibrimeve;
- ✓ përgjegjësitë në lidhje me planifikimin e testeve dhe/ose kalibrimeve dhe vlerësimin e rezultateve;
- ✓ përgjegjësitë për raportimin e opinioneve dhe interpretimeve;
- ✓ përgjegjësitë në lidhje me modifikimin e metodës dhe zhvillimin dhe validimin e metodave të reja
- ✓ ekspertiza dhe përvoja e kërkuar;
- ✓ kualifikimet dhe programet e trajnimit;
- ✓ detyrat menaxheriale.

[Laboratorët duhet të sigurojnë që personeli i përfshirë në kryerjen e analizave të monitorohet rregullisht, se është kompetent dhe vepron në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë të trupit të inspektimit.](#)

[Personeli menaxherial dhe teknik për inspektime mund të jenë i njëjtë, por funksionet dhe përgjegjësitë duhet të dokumentohen qartë në përshkrimin e punës nga trupi inspektues.](#)

[Ngjashëm, menaxhmenti i trupit inspektues dhe menaxheri i cilësisë mund të jenë të njëjtë, por funksionet dhe përgjegjësitë duhet të dokumentohen qartë në përshkrimin e punës nga trupi inspektues.](#)

#### **Nënkontraktimi**

Laboratorët do të nënkontraktjnë vetëm laboratorët e akredituar, siç janë përcaktuar nga ISO / IEC 17025.

Laboratorët duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë në mënyrë të pavarur rezultatet e testeve të nënkontraktuara. Përgjegjësia për vendosjen e konformitetit me kërkesa i mbetet laboratorëve.

Laboratori duhet të informojë klientët e tij paraprakisht për nënkontraktimin.

Kur një laborator nënkontraton punën, qoftë për shkak të arsyeve të paparashikuara (p.sh. ngarkesën e punës, nevojën për ekspertizë të mëtejshme ose paaftësi të përkohshme) ose në baza të vazhdueshme (p.sh. nëpërmjet nënkontraktimit të përhershëm, me agjenci ose marrëveshjet e franshizës), kjo punë do të vendoset me një nënkontraktor kompetent. Një nënkontraktor kompetent është ai që, për shembull, është në përputhje me këtë Standard Ndërkombëtar për punën në fjalë.

### ***Pika 7 Kërkesat e procesit***

Një laborator duhet të përdorë metoda dhe procedura të përshtatshme për të gjitha testet dhe/ose kalibrimet brenda fushëveprimit të tij. Këto përfshijnë marrjen e mostrave, trajtimin, transportimin, ruajtjen dhe përgatitjen e artikujve që duhet të testohen dhe /ose kalibrohen dhe, kur është e përshtatshme, një vlerësim të pasigurisë së matjes, si dhe teknikat statistikore për analizën e të dhënave të testimit dhe /ose kalibrimit.

Laboratori duhet të ketë udhëzime për përdorimin dhe funksionimin e të gjitha pajisjeve relevante, si dhe për trajtimin dhe përgatitjen e artikujve për testim dhe /ose kalibrim, ose të dyja, nëse mungesa e udhëzimeve të tilla mund të rrezikojë rezultatet e testeve dhe /ose kalibrimeve. Të gjitha udhëzimet, standardet, manualët dhe të dhënat referuese të lidhura me punën e laboratorit duhet të mbahen të përditësuara dhe duhet të jenë në dispozicion të personelit (shih 6). Devijimi nga metodat e testimit dhe kalibrimit duhet të ndodhë vetëm nëse devijimi është dokumentuar, i justifikuar teknikisht, i autorizuar dhe i pranuar nga klienti.

### ***Pika 8 Kërkesat e sistemit të menaxhimit***

Laboratori i testimit dhe kalibrimit duhet të dokumentojë sistemin e tij të menaxhimit brenda procedurave sipas kërkesave të EN ISO/IEC 17025.

Është përgjegjësi e laboratorit të kryejë aktivitetet e testimit dhe kalibrimit në mënyrë të tillë që të përmbushë kërkesat e këtij Standardi Ndërkombëtar dhe të plotësojë nevojat e klientit, autoriteteve rregullator ose organizatave që sigurojnë njohjen.

## **7. HISTORIA**

<b>Data e botimit</b>	<b>Përgatitur nga</b>	<b>Përshkrimi i ndryshimeve të aplikuara</b>
1/2.12.2015	Banush Neziri	Dokument i ri
2/11.03.2016	Banush Neziri	Pika 5dhe 6